



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance Qeveria
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIA NABAVKE /CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

TITULLI I KONTRATËS:
SHËRBIME TË TRANSPORTIT AJROR

NUMRI I PROKURIMIT: UA/2016-22-8948-2-1-1

NUMRI I BRENDSHËM I PROKURIMI: AQP-22-011/R-211

NUMRI I KONTRATËS: UA/2016-22-8948-2-1-1/C267

KONTRATA & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA

Agjencia Qendrore e Prokurimit, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

OE: " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K. me adresë: Tringë Smajli 14, 10000, Prishtinë, Kosovë; E-mail: gov@astravel-club.com , Nr.Telefoni: 038245888; NUI: 810886616, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike kornizë për shërbimet e shënuara me poshtë:

Titulli: Shërbime të Transportit Ajror

Numri i prokurimit: UA/2016-22-8948-2-1-1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve: Shërbimet e transportit ajror, ku përfshihen rezervimi, procedimi dhe dërgimi i biletave të aeroplanëve sipas kërkesave të AK-ve që shfrytëzojnë këtë kontrate.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën 22.09.2022.
- 1.3 Kjo kontratë publike ka kohëzgjatje prej 12 muaj dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hynë në fuqi deri me datën 21.09.2023.

Neni 2 Çmimi

2.1 Vlera totale e parashikuar e kontratës është 1,620,000.00€ (një milion e gjashtëqindnjëzet mijë euro), sasia totale indikative e kontratës është 4000 bileta. Çmimi për Tarifën e shërbimeve është 5.00€ për biletë apo 20,000€ për totalin indikativ të biletave. Devijimi i lejuar është +/-30% i sasisë së biletave (4000) apo i çmimit total indikativ të Tarifës së Shërbimeve (20,000€).

Çmimi i Tarifës së shërbimit është fiks dhe nuk ndryshon ndërsa çmimi i biletës është variabil pasi që çmimi i biletave krijohet nga çmimi që gjenerohet nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo çmimet momentale në ueb faqet e aviokompanive kur rezervohet biletë varësisht se ku është çmimi më i lirë për kohën dhe destinacionin e kërkuar nga AK. Këtij çmimi i shtohet Tarifa e Shërbimit dhe formohet çmimi total i biletës.

2.2 Çmimi total i biletës i formuar siç është paraqitur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Mënyra e formimit të çmimit dhe Tarifa e Shërbimit duhet të jenë vetëm sipas kushteve të kontratës dhe Tarifa e Shërbimit duhet të mos i nënshtrohen ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës dhe Aneksit 1 Specifikimet teknik që është pjese e kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Aneksi 1 -Specifikimet Teknike;
- (e) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve,
- (f) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen në e-prokurim apo me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Mehmet Rama	Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.09.2022	Data:	22.09.2022
Vula:		Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	FLAMUR BAHTIARI
Pozita:	DREKTOR
Nënshkrimi:	
Data:	22.09.2022
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënie e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur

arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston

ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13

Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet të bëhen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bërë porosinë anulon porosinë dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të njoftojë Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskojë një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% të porosisë së lëshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marrë dhe do të ruajë, dhe do të shkaktojë Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga reziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofrojë dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka

Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë asemi të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATES: KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Transferimi	3	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit, transferimi lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit nënkontraktimi lejohet gjatë fazës së implemtimit vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK..
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe Autoriteteve kontraktuese që shfrytëzojnë këtë kontratë. Çdo Autoritet Kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë, brenda 5 (pese) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që ta caktoj Menaxherin dhe ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës dhe me një kopje duhet të Njohetohet AQP-ja.
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Kontraktuesi, në baza Një (1) mujore, do të raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasinë e biletave të dorëzuara dhe institucionet që i kanë porositur ato bileta. Raporti duhet të paraqesë: 1. Sasinë e biletave gjatë 1 muaji; 2. Biletat e anuluar për të cilat është paguar ndëshkim 3. Datën e faturave; 4. Datën e pagesave; Agjencia Qendrore e Prokurimit do të hartoj një model të Raportit dhe do ta dërgoj të kontraktuesi jo më vonë se 20 dite nga nënshkrimi i kontratës. Obligohet furnizuesi që ta shfrytëzoj këtë model të Raportit gjatë raportimit të AQP-ja. AQP mund të kërkojë edhe raporte më të detajuara nëse e vlerëson të nevojshme. Mos raportimi me kohë pranë AQP-së nga ana e kontraktuesit, e detyron AQP-në që të marrë masa, siç është konfiskimi i garancionit të ekzekutimit dhe lëshimin e Referencës negative për kontratën e nënshkruar. Kontraktuesi obligohet që për çdo muaj të dorëzojë në AQP një kopje të raportit të biletave të shitura tek AK/njësi kërkuuese përkatëse, të nxjerrë nga sistemi BSP (Billing and Settlement Plan),
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.2	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.

Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.4 dhe 7.5	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.4 dhe 7.5 i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Kontraktuesi do të emërojë një përfaqësues (Menaxher), i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e kontraktuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet të jetë në dispozicion çdo herë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues	9.1	Autoriteti Kontraktues këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i shërbimeve	10	Autoriteti Kontraktues këtë nen i referohet cilitdo autoritetit kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë, dhe ndërprerja e shërbimeve/kontratës mund të bëhet vetëm për autoritetet kontraktuese që nuk përmbushin obligimet por jo për kontratën në tërësi.
Obligimet e ofruesit të shërbimeve	11.1	Autoriteti Kontraktues këtë nen i referohet cilitdo autoritetit kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.
Obligimet e ofruesit të shërbimeve	11.5 & 11.6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.1	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritetit kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Çdo Autoritet Kontraktues/Njësi kërkuese që shfrytëzon këtë kontratë, brenda 5 (pese) ditëve, pas pranimi të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës Çdo Autoritet Kontraktues/Njësi kërkuese që shfrytëzon këtë kontratë do të emërojë një, përfaqësues si pikë koordinimi ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe ofruesit të shërbimeve i cili do të jetë në dispozicion çdo herë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës
Dëmet e Likuiduara	13	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritetit kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 170,000.00€ me kohëzgjatje prej 13 muaj prej data e hyrjes në fuqi të kontratës.
Parimet të përgjithshme të pagesave	16	Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga secili Autoritet Kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë për vlerën e biletave të porositura nga AK përkatës. Me rastin e procesimit dhe dërgimit të biletës nga kontraktuesi tek Autoriteti kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë dërgohet edhe fatura dhe fillojnë afatet kohore të parapara me nenin 16 të KPK. Pavarësisht që kontraktuesi kryen shërbimin e parapara me këtë kontratë me rastin e dorëzimit të biletës dhe i mundësohet dorëzimi i faturës kontraktuesi do të jetë përgjegjës deri në përfundimin e fluturimit të përfshirë në atë biletë. Faturat mund të dorëzohen në formë fizike ose elektronike. Ofruesi i Shërbimeve duhet të dorëzojë tek secili AK që shfrytëzon këtë kontratë një faturë origjinale dhe një kopje të biletës si dhe duhet të bashkëngjitet edhe printimi i çmimit të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit për secilën biletë të porositur nga ai AK. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro.
Parimet të përgjithshme të pagesave	16.5	Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 të kushteve të përgjithshme do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që të mos e realizojë kontratën për Autoritetin kontraktues që nuk ka kryer pagesat, me paralajmërim prej 30 ditësh

		për Autoritetin kontraktues përkatës dhe AQP-në. Vendimi i kontraktuesit për të mos ofruar shërbimet për ndonjë AK sipas këtij neni, ndikon në eliminimin e pragut minimal (-30%) të devijimit të lejuar të kontratës.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Autoritetet Kontraktuese dhe AQP rezervon të drejtën për të kontrolluar çdo dokument që përshkruan kërkesat e kësaj kontrate gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe inspektimi mund të realizohet drejtpërdrejt tek zyrat e ofruesit të shërbimeve . Në secilin rast të rezervimit të biletës përgjegjësin për të gjitha kontrollet e çmimit dhe të gjitha kushteve tjera e bartë menaxheri i kontratës nga institucion që porositë atë biletë.
Raportimi pranë AQP-së		Në rast se kërkohet nga AQP-ja, Autoriteti kontraktues obligohet të raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasinë e biletave të pranuar nga Kontraktuesi. Raporti mund të kërkohet të paraqesë: 1. Sasinë e biletave gjatë 1 muajve; 2. Llojin e biletave sipas relacioneve 3. Datën e faturave; 4. Datën e pagesave; 5. Raportin lidhur me dëmet e likuiduara. Agjencia Qendrore e Prokurimit do të hartoj një model të Raportit dhe do ta dërgoj AK-së me rastin e kërkesës për raportim. Obligohet AK-ja që ta shfrytëzoj këtë model të Raportit gjatë raportimit në AQP. Kontraktuesi obligohet që për çdo muaj të dërgojë një kopje të raportit të biletave të shitura tek AK/njësi kërkuese përkatëse, të nxjerrë nga sistemi BSP (Billing and Settlement Plan),
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore , përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues – AQP-se , dhe zyrtaret përgjegjës të Autoriteteve Kontraktuese që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të ofruesit të shërbimeve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente, në pajtim me ligjin e Kosovës.

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE

Qëllimi i këtij aktiviteti është që të lidhet një kontratë kornizë me një Operator ekonomik (OE) të kualifikuar i cili do të ofronte shërbimet e rezervimit dhe lëshimit të aviobiletave për udhëtimet zyrtare që do të autorizohen nga Autoritetet kontraktuese (AK) të nivelit qendror dhe atij lokal.

Gjatë periudhës një vjeçare numri i përafërt i biletave do të jetë 4000 në destinacione të ndryshme të botës. Kontrata konsiderohet e realizuar në bazë të sasive të biletave dhe jo vlerës.

Ofruesi i shërbimeve i suksesshëm duhet të rezervojë dhe të lëshojë aviobiletë, duke pasur parasysh që të jenë me çmimin më të lirë të mundshme duke kombinuar rrugët e drejtpërdrejta dhe më çmime sa më të favorshme për të arritur më kosto sa më të ultë që është e mundur.

Ofruesi i shërbimeve duhet të përgjigjë jo më shumë se 6 orë nga momenti i kërkesës nga AK-se në rastet kur janë kërkuar biletat në formë elektronike.

Në raste të jashtëzakonshme kur biletat e udhëtimit nuk mund të dorëzohen në formë elektronike ato duhet të dorëzohen në letër në ambientet e AK ose drejtpërdrejt tek udhëtari jo më vonë se 12 orë pas kërkesës. Preferencë janë biletat elektronike kur janë në dispozicion apo të zbatueshme. Asnjë pagesë shtesë nuk do të bëhet për këtë shërbim dorëzimit. Ofruesi i shërbimeve do të dërgojë bileta të veçanta për çdo udhëtar.

Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë në gjendje të sigurojë shërbimet e lartpërmendura, duke përfshirë ofrimin e aviobiletave gjatë orarit të punës (e hënë deri të premten 8:00-16:00) gjithashtu duhet të ofroj shërbime jashtë orëve normale të punës, si edhe gjatë fundjavave dhe festave.

Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë në gjendje për të garantuar Shërbime 365 ditë në vit, 7 ditë në javë dhe 24 orë në ditë dhe duke ofruar emrat e personave të kontaktit, emailat dhe numrin e telefonit kjo do të jetë si kusht pas nënshkrimit të kontratës (kjo është një kërkesë e detyrueshme).

Ofruesi i shërbimeve duhet të ofrojë ndihmë personave në udhëtimet zyrtare dhe t'i informojnë ata menjëherë për çdo ndryshim, anulim ose probleme me udhëtimet e tyre.

Ofruesi i shërbimeve do të sigurojë personelin adekuat në ambientet e tij të biznesit që do jenë të dedikuara për ofrimin e shërbimeve për këtë kontratë, në mënyrë që të sigurojë respektimin e kohës për kërkesat e pranuar dhe duke ruajtur cilësinë e shërbimeve.

Ofruesi i shërbimeve duhet të jetë në gjendje të caktojë personel shtesë gjatë periudhave të pikut për të siguruar cilësi të lartë të shërbimit. Ofruesi i shërbimeve i suksesshëm gjithashtu do të emërojë një menaxher të kontratës Brenda biznesit të tij, i cili do të koordinojë ofrimin e shërbimeve për AK, do të merret me komunikimin me AK, mbikëqyrë dhe menaxhojë kërkesat AK, për tu përgjigjur në pyetje, dhe për të ndihmuar në rast të kërkesave të veçanta që AK mund të kenë nevojë.

Kërkesat për shërbimet që do të ofrohen do të dërgohen tek Ofruesi i shërbimeve me shkrim përmes emailit kurdoherë që është e mundshme ose përmes telefonit ose direkt në zyrat e Ofruesit të shërbimeve.

Kontraktuesi është i obliguar të vendos **kamera para kompjuterit** që të xhirohet e gjithë procedura e rezervimit të biletës, tek një kompjuter në zyrën e kontraktuesit dhe të gjitha ato xhirime duhet të ruhen nga kontraktuesi dhe secila video duhet të jetë e qartë dhe e pastër ku mund të verifikohet çmimi, datat dhe të gjitha të dhënat gjatë rezervimit të biletës. Xhirimi duhet të përfshijë gjithë procesin e rezervimit të biletës. Pas pranimi të porosis nga AK kontraktuesi duhet të fillojë xhirimin për atë biletë, ku duhet të shihet vendosja e të dhënave, kërkimi për opsione të ndryshme e deri tek procesimi i biletës. Secila biletë duhet ta ketë xhirimin e vetë, përveç rasteve kur në të njëjtën kohë rezervohen disa bileta. Rezervimi i biletave jashtë orarit të rregullt të punës (08-16) dhe ditëve të fundjavës mund të bëhet edhe pa xhirim por me disa foto/screenshot të momentit të procesimit ku duhet të shihet çmimi. Rezervimi i biletave jashtë orarit të punës nënkupton kur porosia nga AK bëhet jashtë orarit të punës e për këtë AK

duhet të ketë arsye objektive, pra nëse porosia nga AK bëhet brenda orarit të punës kontraktuesi është i obliguar ta ketë xhirimin.

Secila bilete duhet të kontrollohet nga menaxheret e kontratës tek secili institucion që e porosit dhe të mos pranohet si dhe të mos paguhet nëse nuk plotësohen kushtet nga kontraktuesi siç janë: videot, fatura, opsionet në rast se me faturë nuk bashkëngjiten të gjitha këto dokumente, AK nuk ka obligim ndaj kontraktuesit.

Rezervimet duhet të bëhen kryesisht në klasë Ekonomike, gjithmonë me qëllim që të kemi koston më efektive dhe të përshtatshme dhe me çmimin më të mirë në dispozicion në treg, gjithashtu do të ketë kërkesa edhe për aviobileta në biznes klasë.

Ofruesi i shërbimeve mund të i kërkohet për të dërguar opsione shtesë në të cilën AK-ve do të ju ofrohen oferta me më të mira në aspektin e kohës, itinerarit dhe koston dhe këto oferta duhet të jenë se paku tri oferta nga kompani të ndryshme ajrore duke përfshirë (nëse aplikohet) një nga një kompani ajrore me kosto të ulët (Low cost) që mbulon destinacionin e synuar.

Ofruesi i shërbimeve do të informojë menjëherë AK në rastet e ndryshimeve në fluturimet e planifikuara, ndonjë vonese, anulimet, kushtet e këqija të motit të cilat do të ndikojnë në orarin e udhëtimit, rregulloret e reja të mundshme të zbatueshme, grevat e planifikuara, apo ngjarje të tjera të cilat mund të ndikojnë në udhëtimet e autorizuara nga AK.

Nga Ofruesi i shërbimeve mund të kërkohet për të siguruar informacion të shpejtë për nevojat e stafit që realizojnë udhëtime zyrtare për transportet ajrore si dhe akomodimet(hotele). Ky informacion duhet të sigurohet sa më shpejt që është e mundur dhe në çdo rast brenda (1) një dite pune nga data e kërkesës.

Pagesa do të bëhet drejtpërdrejt nga AK që kanë porositur biletat tek Ofruesi i shërbimeve brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të faturës dhe pas dorëzimit të biletave (në rastin e faturimit korigjues, data e faturës së fundit korigjuese do të merret parasysh)

Asnjë faturë nuk do të pranohet nëse kanë kaluar gjashtë (6) muaj nga dita e shërbimit të kryer.

AK kane të drejtë të refuzojnë, duke njoftuar me shkrim Ofruesi i shërbimeve, për çdo shërbim i cili dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të përcaktuara në këtë specifikim teknik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit të kontratës do të shpërndajë nga një kopje të nënshkruar të kontratës tek secili Autoritet Kontraktues dhe Një kopje të kontratës së nënshkruar do të publikohet në webfaqen e AQP-se.

Nga Ofruesi i shërbimeve kërkohet që të ofrojë të dhëna statistikore për AQP përgjatë zbatimit të kontratës në baza gjashtë mujore që përshkruajnë shërbimet e dorëzuara për AK, duke përfshirë se paku emrin e AK, biletat e shitura sipas muajve me çmime.

AK dhe AQP mbajnë të drejtën në çdo kohë për të kërkuar një kopje të marrëveshjes financiare apo faturë ndërmjet ofruesit të shërbimeve apo aviokompanive apo qasje të drejtpërdrejt në sistemin kompjuterik të rezervimeve që janë subjekt i kësaj kontrate me qëllim që të garantohet që çmimi i paguar i biletave nuk është më i lartë se sa është kontraktuar.

Kontraktuesi obligohet që për çdo muaj t'i dërgojë një kopje të raportit të biletave të shitura tek AK/njësi kërkuuese përkatëse, të nxjerrë nga sistemi BSP (Billing and Settlement Plan), ku ceken qartë pagesat e kryera nga Ofruesi i shërbimeve të kompanitë ajrore përkatëse për secilën biletë që Ofruesi i shërbimeve e ka shitur për AK përkatëse dhe një raport tjetër për të gjitha biletat që janë rezervuar online përmes aviokompanive që ofrojnë rezervime online në web faqet e tyre, këtij raporti duhet t'i bashkëngjiten "Screenshots" të momentit të rezervimit të secilës biletë.

AQP rezervon të drejtën për të kontrolluar dhe monitoruar drejtpërdrejt në sistem, në çdo dokument që përshkruan kërkesat e lartë përmendura gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Të gjitha kërkesat e përshkruara më lartë janë të detyrueshme dhe do të bëhen pjesë integrale e kontratës. Mosrespektimi i tyre gjatë zbatimit të kontratës përbën një arsye për AQP-në që të mund të ndërpresë kontratën.

Në rast të anulimit të udhëtimit nga AK, Ofruesi i shërbimeve do të përpiqet për të minimizuar çdo ndëshkim që është shkaktuar me gabimin/anulimin nga AK. Ndëshkime që vijnë si pasojë e gabimeve të Ofruesi i shërbimeve nuk do të pranohen.

Zgjidhja e kontesteve gjatë implementimit ku nuk janë si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit apo njësisë kërkuese, p.sh.

Dorëzimi i biletës nga kontraktuesi është bërë me: 29 Dhjetor, 2020 në ora 3:45 pm Ndërsa,

Kërkesa për anulim të biletës nga AK është bërë me: 16 Janar, 2021 në ora 2:03 pm

Në bazë të kësaj mund të konkludojmë që AK ka kërkuar anulimin dhe nuk është pasojë e gabimeve të kontraktuesit, prandaj në raste të tilla kontraktuesi duhet të tregoj që është përpjekur për të minimizuar ndëshkimin.

Për informim çdo aviokompani si p.sh. Austrian Airlines, Turkish Airlines etj. Kanë politiken e vetë të anulimit të udhëtimeve dhe aty përcaktohen kushtet për anulimin e udhëtimit (këto kushte lehtë mund të gjinden në çdo ueb site të avio kompanive) nga ana e pasagjerit, prandaj AK mund të kërkojnë se si është kalkuluar shuma për kthim, duke kërkuar gjithashtu edhe në cilën aviokompani është blerë bileta nga ana e kontraktuesit për të konstatuar se a janë në pajtim me këto kushte.

Kontraktuesi me rastin e rezervimit të biletës është i obliguar të njoftoj AK se deri në cilën kohë mund të anulohet bileta pa ndëshkim.

Për biletat e anuluar Kontraktuesi duhet të faturtoj AK vetëm për pjesën e ndëshkimit, kjo pasi kontraktuesit i janë kthyer mjetet "refund" nga aviokompanitë dhe pjesa e ndaluar nga avio kompanitë "ndëshkimi" do të ju faturohet AK që ka porositur atë biletë. Për biletat e anuluar për të cilat paguhet ndëshkim do të paguhet "service charge" dhe do të llogariten në sasinë e biletave në kontratë dhe për këtë Kontraktuesi është i obliguar t'i përfshi në raport (për biletat e anuluar për të cilat nuk paguhet ndëshkim nuk do të përfshihen në raport e as në sasinë e kontratës si dhe nuk do të faturohet/paguhet "service charge")

Çmimi i biletave krijohet nga çmimi që gjenerohet nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo çmimet momentale në web faqet e aviokompanive kur është rezervuar bileta plus tarifa e shërbimit (service charge) sipas shumës fikse të ofruar nga kontraktuesi e paraqitur në numrin rendor 2 të Listës së Çmimeve.

Në rastet kur një biletë së rezervuar me kërkesë të AK i shtohet bagazh shtesës, ndryshim në ulëse apo çfarëdo ndryshimi tjetër që është i mundshëm do të paguhet vetëm kosto e atij ndryshimi por jo edhe tarif e re e shërbimit "service charge", këto shërbime do të vendosen në raport nga kontraktuesi si shtesa të biletës bazë (por të ceket ndryshimi dhe kosto).

Kontraktuesi është i obliguar që faturës të bashkëngjis edhe printimin e biletës elektronike me çmimin e lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo faturat e aviokompanive për rezervime online duke përfshirë edhe rezervimin e biletës së bashku me maskën e biletës, si dhe videot nga kamera.

Pagesa do të bëhet drejtpërdrejt nga AK që kanë porositur biletat tek Ofruesi i shërbimeve Brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të faturës dhe biletës. Në rastin e faturimit korrigjues, data e faturës së fundit korrigjuese do të merret parasysh.

Institucionet shfrytëzuese të kësaj kontrate nëse dyshojnë për biletat (të saj) e porositura ruajnë të drejtën, që gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, pa paralajmërim të inspektoj Ofruesin e shërbimeve për të kontrolluar se çmimi i lëshuar nga sistemi BSP (Billing and Settlement Plan apo sisteme që janë përdorur për nxjerrjen e biletave), a përputhen me çmimet e biletës elektronike të dorëzuar me fature, apo edhe çdo formë tjetër të kontrollit për shërbimet që hyjnë në fushën e kësaj kontrate dhe

për çdo mashtrim që dëshmohet AQP do të ndërpresë menjëherë kontratën dhe do të konfiskojë sigurimin e ekzekutimit të kontratës.

Tarifa e shërbimit e shprehur në shumë fikse dhe e paraqitur në numrin rendor 2 të tabelës së çmimeve, gjatë realizimit të kontratës është e pa ndryshuar dhe çdo here aplikohet në vlerën totale të çmimit variabël të biletës të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit apo çmimet e gjeneruar online.

Kontraktuesi obligohet që për çdo muaj të dorëzojë një kopje të raportit të biletave të shitura Autoriteteve kontraktuese dhe AQP-së, të nxjerrë nga sistemi BSP (Billing and Settlement Plan), ku ceken qartë pagesat e kryera përkatëse për secilën biletë që ofruesi i shërbimit e ka shitur për Autoritetin kontraktues. Raporti i BSP duhet të jetë i filtruar për secilin Autoritet Kontraktues veç e veç që kanë shfrytëzuar kontratën gjatë atij muaji.

Autoriteti kontraktues mund të bëjë verifikime shtesë rreth zbatimit të obligimeve të operatorit ekonomik nga kjo kontratë.

Sasia e biletave dhe destinacionet mund të ndryshojnë varësisht nga kërkesat dhe nevojat e Autoriteteve Kontraktuese dhe biletat kryesisht do të jenë kthyesë por mund të ketë kërkesa një drejtimësh dhe disa drejtime.

Kontraktuesi ka përgjegjësi për furnizim me kompjuter, programin për përdorimin e sistemit të BSP apo ekuivalent, instalimin dhe blerjen/vendosjen e kamerës para kompjuteri.

Nëse AQP pranon kërkesë për verifikimin e ndonjë bilete atëherë AQP ka të drejt të caktoj një zyrtar të vetin të cilit do ti jepet qasja me userin e kontraktuesit ku do të mund të thirren/shikohen biletat e rezervuara sipas kërkesës.

Për të rezervuar biletë AK do i dërgojë kontraktuesit kohën dhe destinacionin ndërsa kontraktuesi do i dërgoj opsionet, pas dërgimit të opsioneve duke përfshirë edhe çmimet AK do të lëshoj Urdhër blerjen, duke pasur parasysh që mund të ketë lëvizje të çmimit të biletës gjatë kësaj kohe nëse ndodhë diçka e tillë kontraktuesi do ta informojë AK. AK mund të bëjnë porosinë e biletave pa urdhër blerje në rastet jashtë orarit të rregullt të punës apo ditëve të pushimit, në këto raste AK duhet të kenë arsye objektive që porosia e biletës nuk ka qenë e mundur të bëhet brenda orarit të rregullt të punës (08-16). Kontraktuesi ka të drejt që me pajtimin e tij të rezervoj bileta edhe vetëm me porosi nga AK pra pa urdhër blerje.

Prokurimi: UA/2016-22-8948-2-1-1

Nr i brendshëm: AQP-22-011-R-211

Tituli: Shërbime të Transportit Ajror - Ritender

1 Shërbime të Transportit Ajror - Ritender

Kodi i tenderit: AS-1409

Data: 14.09.2022

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1 - Siguria e Tenderit.pdf
2.	2 - Aneksi 3 - Kerkesat per Sekret Afaris.pdf
3.	3 - Dëshmitë e Pranueshmerise se Operatorit Ekonomik.pdf
4.	4 - Dëshmitë e Kerkesave te Pershtatshmerise Profesionale.pdf
5.	5 - Dëshmitë e Kerkesave mbi Gjendjen Ekonomike dhe Financiare.pdf
6.	6 - Dëshmitë e Kerkesave mbi Mundësitë Teknike dhe Profesionale.pdf
7.	7 - Identifikimi Financiar.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Shërbime të Transportit Ajror - Ritender	Përshkrimi i cmimit.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

Sigurimi i Tenderit

Aneksi 3- Kërkesat për Sekret Afarist

Dëshmitë e Pranueshmerisë së Operatorit Ekonomik, neni 6.4 i FDT

Dëshmia 1: Deklarata nën Betim - Aneksin 2.

Dëshmia 2: Vërtetim nga Gjykata

Dëshmia 3: Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës

Dëshmitë e Kërkesave të Përshtatshmërisë Profesionale, neni 7.1 & 7.2 i FDT

Dëshmia 1. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit – NUI

Dëshmia 2: Licenca valide për vitin 2022 nga IATA

Dëshmitë e Kërkesave mbi Gjendjen Ekonomike dhe Financiare, neni 8.1 & 8.2 i FDT

- Deklarata Tatimore Vjetore 2019

- Deklarata Tatimore Vjetore 2020

- Deklarata Tatimore Vjetore 2021

Dëshmitë e Kërkesave mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale, neni 9.1 & 9.2 i FDT

Dëshmia 1:

Vertetim nga ProCredit Bank të datës 01.09.2022 për pagesat që janë bërë nga AS Travel Club Sh.P.K te IATA.

Dëshmia 2:

- Diplomave profesionale të punëtorëve të lëshuara nga Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror (International Air Transport Association- IATA);
- Kopjet e kontratave të punës së dy punëtorëve dhe para kontrata e një punëtoreje;
- Dëshmi të pagesës së kontributit pensional në FKPK (Trusti).

Dëshmia 3:

- Certificate e lëshuar nga AMADEUS , Nr. 0-179/22 e datës 09.08.2022
- Raporti-Lista e pajisjeve

Pjesa V e Kontrates – Identifikimi Financiar

AUTORITETI KONTRAKTUES

Agjencia Qendrore e Prokurimit , Ndertesa e Germis, 10000, Prishtinë,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: UA/2016-22-8948-2-1-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K., Tringë Smajli 14, 10000, Prishtinë, Kosovë

E-mail: info@astravel-club.com

Personi kontaktues: Flamur Bahtijari

Telefoni: 038/245/888

Faxi:

Numri fiskal: 600861737

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: UA/2016-22-8948-2-1-1

Titulli i kontratës: Shërbime të Transportit Ajror - Ritender

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Shërbime të Transportit Ajror - Ritender

3. Çmimi total i tenderit është:

1 620 000,00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 120 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

LISTA E ÇMIMEVE

NR.	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA E PËRAFËRT PËR 12 MUJ	ÇMIMI NJËSI DDP-1 PLANIFIKUAR*	ÇMIMI TOTAL I PLANIFIKUAR
1.	Bileta Aeroplani	Copë	4000	400	1,600,000.00
2.	Tarifa e shërbimit (service charge) e ofruar nga Operatori Ekonomik i shprehur ne Euro	Copë	4000	5.00 €	20,000.00
3.	VLERA TOTALE E OFERTES (VLERA E SHENUAR NE NUMRIN RENDOR -1PLUS VLERA E SHENUAR NE NUMRIN RENDOR -2)				1,620,000.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	"AS Travel Club" Sh.P.K
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUE TE OE:	Flamur Bahtijari
NËNSHKRIMI:	
DATA:	14.09.2022
VULA:	

*Vlera e biletës prej 400 euro është një vlerë që shërben vetëm për kalkulim të çmimit dhe çmimi total do të përdoret vetëm për nevojat e vlerësimit të tenderit dhe nuk përcakton çmimin real të kontratës pasi që çmimi do të krijohet përgjatë zbatimit të kontratës nga çmimet që do të procedohen nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO,SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo sisteme online. Kontrata do te bazohet ne sasi.

*Tarifa e shërbimit duhet dhënë vetëm me dy numra pas presjes dhjetore, (p.sh. 3.59 €). Çdo numër i shënuar pas dy (2) numrave të presjes dhjetore nuk do te merret për bazë ne llogaritje te vlerës së ofertës.

Vëmendje:

- Çmimi i biletave krijohet nga çmimi qe gjenerohet nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO,SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm apo nga çmimet në kohe reale ne web faqet e aviokompanive që rezervimin e ofrojnë online plus tarifa e shërbimit (servicecharge) sipas shumës fikse te ofruar ne tenderin tuaj të paraqitur ne numrin rendor 2 te Listës se Çmimeve.
- Fituesi i kësaj kontrate është i obliguar që faturës duhet ti bashkëngjitet edhe printimi i biletës elektronike me çmimi të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit AMADEUS, GALILO,SABRE, apo sistem tjetër të barasvlershëm, kur rezervimi behet ne web faqet e avikompanive kontraktuesi duhet te bashkëngjisë edhe një "screenshot" te momentit te rezervimit te biletës, duke

përfshirë edhe rezervimin e biletës së bashku me maskën e biletës. Gjithashtu duhet të vendoset kamera para kompjuterit që të xhirohet e gjithë procedura e rezervimit të biletës, tek një kompjuter në zyrën e kontraktuesit dhe të gjitha ato xhirime duhet të ruhen nga kontraktuesi dhe secila video duhet të jetë e qartë dhe e pastër ku mund të verifikohet çmimi, datat dhe të gjitha të dhënat gjatë rezervimit të biletës.

- Paga do të bëhet drejtpërdrejt nga AK që kanë porositur biletat tek Ofruesi i shërbimeve brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të faturës dhe biletës në rastin e faturimit korigjues, data e faturës së fundit korigjuese do të merret parasysh.
- Tarifa e shërbimit e shprehur në shumë fikse dhe e paraqitur në numrin rendor 2 të tabelës së çmimeve, gjatë realizimit të kontratës është e pa ndryshuar dhe çdo here aplikohet në vlerën totale të çmimit variabël të biletës të lëshuar nga sistemi kompjuterik i rezervimit ose nga rezervimet online.
- Nëse rastësisht Autoritetet Kontraktuese pranon dy e më shumë oferta tepërgjegjshme me çmime të njëjta, oferta e përgjegjshme e cila është dorëzuar e para do të shpërblehet me kontratë.



Numri i Prokurimit: AQP/22/011-R/211- Titulli Shërbime të transportit ajror - Ritender


PJESA V E KONTRATËS:

IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	As Travel Club SHPK
Adresa	Tringe Smajli
Qyteti	Prishtine
Kodi Postar	10000
Kontakti	Flamur Bahtijari
Telefoni	038245888
Faks	
E-mail	info@astravel-club.com
Numri i TVSH	330174706

BANKA	
Emri	ProCredit Bank
Adresa	Rr. Xhorxh Bush, Nr.26
Qyteti	Prishtine
Kodi Postar	10000
Shteti	Republika e Kosoves
Llogaria Bankare	1110-313698-0001-79
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGENCIJA E REGJISTRIMIT E BIZNESIT E KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJU BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810886616

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

As Travel Club SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:

Tringë Smajll Ob-6 Hy 1-Nr3
Prishtinë

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

16/04/2009

05/04/2019

Data / Date / Datum



W. Zeković

Nënshkrimi / Signature / Potpis

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10016713



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 106602

Për Agjencia Qendrore e Prokurimit

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **As Travel Club SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Sherbime te transportit ajror-Ritender**

Nr. prokurimit: UA/2016-22-8948-211 , Nr. brendshëm: AQP 22 011 R 211

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **170,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **170,000.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 396 ditë kalendarike prej **22.09.2022** deri më **23.10.2023**

Data lëshimit: 21.09.2022

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



Menaxheri i Kontratës nga " AS TRAVEL CLUB " SH.P.K.

Flamur Bahtijari

Detajet :

flamur@astravel-club.com

045 245 888

044 158 544

Te gjitha kërkesat duhet te dërgohen ne email gov@astravel-club.com